



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONIERI
PËR MBROJTJEN
NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 13 prot.

TIRANË, më 06.01.2022

**QENDRËS
ACT FOR
SOCIETY**

Nr. 69 prot.

TIRANË, më 06.01.2022



MARRËVESHJE

PËR

KOMISIONIERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
përfaqësuar nga Komisioneri, **Z. Robert GAJDA**

DHE

QENDRËS ACT FOR SOCIETY
përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv i Qendrës, **Znj. Armela PENGILI**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe **Qendra ACT for SOCIETY**, më poshtë të quajtura “palë”,

Referuar eksperiencës dhe përvojës së gjatë në garantimin e zbatimit dhe realizimit të misioneve të përbashkëta në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dëshirojnë që të çojnë përpara bashkëpunimin e ndërsjelltë ndërmjet tyre në këtë fushë, nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, për sa më poshtë:

Neni 1 OBJEKTI

Kjo marrëveshje ka për objekt institucionalizimin e bashkëpunimit dhe përcaktimin e rregullave dhe mënyrave brenda të cilave Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Qendra ACT for SOCIETY do të zhvillojnë marrëdhëniet e tyre të bashkëpunimit të ndërsjelltë, në kuadër të punës së përbashkët për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare dhe legjislacionin e brendshëm.

Neni 2 QËLLIMI

Realizimi i veprimtarisë së përbashkët dhe të koordinuar për respektimin, forcimin dhe avancimin e mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut; procesit të menaxhimit të të kthyerve në vendin tonë, angazhimit institucional të të gjithë aktorëve shtetërorë të përfshirë në këtë operacion, si dhe sfidat e hasura në këtë drejtim; rritja e bashkëpunimit në drejtim të forcimit të zbatimit të legjislacionit në fuqi, të transparencës dhe të llogaridhënies; si dhe ndërhyrjen pozitive të institucioneve shtetërore sa herë që është e nevojshme.

Neni 3 FUSHA E ZBATIMIT

Marrëveshja do të zbatohet midis Palëve të lartëpërmendura në fushën që përmban kjo Marrëveshje për të përmbushur qëllimin e saj.

Kjo Marrëveshje do të konsistojë në:

- 3.1 Bashkëpunimin dhe përfshirjen në tryeza konsultimi me shoqërinë civile, mbi çështje me interes të përbashkët.
- 3.2 Përfshirjen nëpërmjet angazhimit institucional të përbashkët për ndryshime ligjore që lidhen me fushat me interes të përbashkët;
- 3.3 Njoftimin e njeri-tjetrit mbi raste konkrete që kërkojnë trajtim institucional;
- 3.4 Organizimin e aktiviteteve si dhe e eventeve të përbashkëta, apo ftesat për pjesëmarrje në konferenca me interes të përbashkët.
- 3.5 Përfshirjen në realizimin e aktiviteteve të përbashkëta në fushën e edukimit, në nivel para universitar dhe universitar;

Neni 4 KOMUNIKIMI NDËRMJET PALËVE

- 4.1. Palët angazhohen të mblidhen në mënyrë periodike, sa herë të gjykohet e nevojshme, por jo më rrallë se një herë në 1 vit.

- 4.2. Palët do të caktojnë një person kontakti, që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret edhe në rrugë operationale të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, si dhe për shkëmbimin e informacionit lidhur me të.
- 4.3. Komunikimi ndërmjet palëve do të jetë në formë shkresore. Për rastet kur palët kërkojnë një informacion të rëndësishëm dhe urgjent për t'u përcjellë, komunikimi mund të bëhet dhe në mënyrë elektronike, por në çdo rast përmes personave të kontaktit.

NENI 5

KOHËZGJATJA


- 5.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga Palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë kohore 4 vjeçare.
- 5.2 Ndryshimet mund të bëhen me marrëveshje nga Palët nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim, duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi.
- 5.3 Çdo mosmarrëveshje krijuar mbi interpretimin ose ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim midis Palëve.
- 5.4 Përveç parashikimit të paragrafit 1 të këtij neni, kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njoftuar paraprakisht 60 ditë para me shkrim palën tjetër.
- 5.5 Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, nënshkruhet dhe protokollohet nga çdo palë dhe secila palë mban një kopje origjinale.
- 5.6 Kjo Marrëveshje është hapur dhe mund t'i bashkohet çdo organizatë jofitimprurëse, objekti i veprimtarisë të së cilës përputhet me këtë Marrëveshje dhe bie dakord me këto parime.

Nënshkruar në Tiranë, më 06 / 01 / 2022.

**KOMISIONERI
PËR MBROJTJEN
NGA DISKRIMINIMI**

KOMISIONER

ROBERT GAJDA



**QENDRA
ACT
FOR SOCIETY**

DREJTORI EKZEKUTIV

ARMELA PËNGILI

